

VENDIM
Nr.34, datë 21.4.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “C & S CONSTRUCTION ENERGY” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.04.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Rapuni 1 dhe HEC Rapuni 2.

2. Shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjise elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratën e koncesionit.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta